

## **BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SHA**

### **VENDIM TEKNIK Nr. 3-C**

**Për**

**"Procedurat e menaxhimit të riskut në Sistemin e Klerimit dhe çështje të tjera të lidhura me to"**

Në mbështetje të dispozitave të:

- I. Kapitulli G dhe Kapitulli E të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
- II. Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.
- III. Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedura e Tregtimit.

#### **ALPEX SHA Miratoi:**

1. Procedurën e menaxhimit të riskut në Sistemin e Klerimit,
2. Vendim Teknik Nr. 3-C i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë – ERE / Zyrës së Rregullatorit për Energji - ZRrE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ADMINISTRATOR I ALPEX SHA**

**Sokol Dishnica**

## VENDIM TEKNIK Nr. 3-C

### NENI 1

#### 1. QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI DHE PËRKUFIZIMET

##### 1.1. Fushëveprimi

- (a) Ky Vendim Teknik përcakton procedurën e menaxhimit të riskut të Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë (në vijim EMCS) në zbatimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për Transaksionet në Tregjet e ALPEX-it dhe çështje të tjera përkatëse.
- (b) Në veçanti, Vendimi Teknik specifikon çështjet e mëposhtme:
  - (i) Metodologjia e Llogaritjes së Margjinës së Kërkuar dhe Riskut Brenda së Njëjtës Ditë (Monitorimi i Kufirit të Kreditit) siç parashikohet në seksionet G.5.1 dhe G.5.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
  - (ii) Përcaktimi i Garancisë së Pranueshme për mbulimin e Margjinës së Kërkuar siç parashikohet në seksionet G.3, G.3.2, G.3.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
  - (iii) Rregullat për llogaritjen e Fondit të Mospërbushjes së Detyrimeve, siç parashikohet në seksionet E.1.2, E.1.3, E.2.1 dhe E.2.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
  - (iv) Rregullat e komunikimit përcaktuar në Shtojcën III.

##### 1.2. Përkufizimet

- (a) Kushtet dhe përkufizimet e përdorura në këtë Vendim Teknik do të kenë të njëjtin kuptim me kushtet dhe kuptimet përkatëse në Përkufizimet e ALPEX-it dhe shpjegimet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, Rregullat e Tregu i Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes dhe Rregullat e Tregu i Energjisë Elektrike - Procedurës së Tregtimit, përveç kur është përcaktuar ndryshe.
- (b) Në të gjitha rastet, dispozitat e këtij Vendimi Teknik interpretohen në përputhje me rregullat dhe parimet e parashikuara në paragrafin B.1.1.9 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

### NENI 2

## **2. LLOGARITJA E MARGJINËS SË KËRKUAR TË SEKSIONIT G.5.1 DHE RISKUT BRENDA SË NJËJTËS DITË TË SEKSIONIT G.5.2 TË RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE - PROCEDURËS SË KLERIMIT DHE SHLYERJES**

### **2.1. Llogaritja e Margjinës së Kërkuar të përcaktuar në seksionin G.5.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes**

- (a) Margjina e Kërkuar llogaritet për Llogari Klerimi gjatë ditës së klerimit dhe pas përmbylljes së pozicioneve (në orën specifike T siç specifikohet nga Vendimi Teknik i ALPEX-it në lidhje me orarin e programuar) me qëllim të verifikimit të mjaftueshmërisë së Garancisë për Llogarinë përkatëse të Klerimit dhe Kufirit të Kreditit siç përcaktohet në seksionin G.5.2 të Kapitullit G të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
- (b) Margjina e Kërkuar llogaritet sipas parashikimeve të seksionit G.5.1 të Kapitullit G të Rregullave Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, siç specifikohet nga ky Vendim Teknik, dhe bazohet në llogaritjen e humbjes që do të shkaktohej nga mos përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga Llogaria e Klerimit të Anëtarit të Klerimit.
- (c) Llogaritja e Margjinës kryhet, bazuar në pozicionin neto (detyrim/pretendim) të Llogarisë së Klerimit, që rrjedh nga transaksionet e përfunduara, të cilat i janë njoftuar EMCS-s gjatë ditës së klerimit. Në mënyrë të veçantë:
  - (i) në qoftë së lind një detyrim për Anëtarin e Klerimit për të paguar një shumë parash, e cila nuk është shlyer ende, kjo shumë vendoset si margjinë.
  - (ii) në qoftë së lind një pretendim për Anëtarin e Klerimit për të marrë një shumë parash, atëherë margjina është e barabartë me këtë shumë por me shenjë negative dhe do të konsiderohet si Garanci e Vlefshme, e cila mund të përdoret si Kufiri i Kreditit të Llogarisë së Klerimit deri në ditën e mëparshme të punës së pagesës kreditore.
- (d) ALPEX ka të drejtë në çdo kohë të ndryshojë metodën e llogaritjes së Margjinës për arsye të mbrojtjes së tregut. ALPEX gjithashtu do të ketë të drejtë të rrisë në çdo kohë Margjinën e Kërkuar për të gjitha Llogaritë e Klerimit së bashku ose individualisht, dhe të caktojë një afat kohor për mbulimin e tyre, veçanërisht duke marrë në konsideratë çdo risk të afërt. Në të dyja rastet ALPEX-i është i detyruar të informojë ERE menjëherë për aplikimin e masave të jashtëzakonshme si dhe arsyet që sollën aplikimin e këtyre masave.

### **2.2. Metodologjia e Llogaritjes së Riskut Brenda së Njëjtës Ditë të seksionit G.5.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes**

- (a) Gjatë seancës së tregtimit, Risku Brenda së Njëjtës Ditë zbritet nga Kufiri i Kreditit të çdo Llogarie Klerimi, bazuar në Urdhërporositë e vlefshme të pa ekzekutuara të vendosura nga Anëtari i Bursës në ETSS dhe transaksionet e përfunduara nga ky i fundit dhe jo të regjistruara në Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS).
- (b) Risku Brenda së Njëjtës Ditë (R brenda së njëjtës ditë) llogaritet si shuma e Riskut që vjen nga Urdhërporositë aktive (R urdhërporositë) dhe Risku nga tregtimet tashmë të përfunduara (R tregtimet), në përputhje me seksionet 2.2.1 & 2.2.3 respektivisht, të këtij Vendimi Teknik.

$$\mathbf{R} \text{ brenda së njëjtës ditë} = \mathbf{R} \text{ urdhërporositë} + \mathbf{R} \text{ tregtimet}$$

- (c) Më specifikisht si më poshtë vijon:
- (i) Sa herë që vendoset një Urdhërporosi ose një kombinim i Urdhërporosive, llogaritet një Risk i ri për këto Urdhërporosi (R urdhërporosi) të vendosura, risk i cili i shtohet Riskut ekzistues. Nëse totali i Riskut Brenda së Njëjtës Ditë (R brenda së njëjtës ditë) është mbuluar nga Kufiri i Kreditit të Anëtarit të Klerimit për Llogarinë e Klerimit dhe Anëtarit të Bursës, Urdhërporosia ose kombinimi i Urdhërporosive do të jenë të vlefshme dhe regjistrohet në Librin e Urdhërporosive.
- (ii) Pas anulimit të çdo Urdhërporosie, Risku i ri i Urdhërporosisë (R urdhërporositë) llogaritet duke zbritur Riskun që është shtuar nga Urdhërporosia e anuluar.
- (iii) Me anulimin e një kombinimi të Urdhërporosive, Risku i ri i Urdhërporosive rillogaritet (R urdhërporositë) duke marrë parasysh Riskun e çdo kombinimi të Urdhërporosive veç e veç. Nëse totali i Riskut Brenda së Njëjtës Ditë (R brenda së njëjtës ditë) mbulohet nga Kufiri i Kreditit të Llogarisë së Klerimit të Anëtarit të Bursës, Urdhërporositë do bëhen të vlefshme dhe regjistrohen në Librin e Urdhërporosive. Nëse nuk mbulohen, atëherë një ose më shumë Urdhërporosi do të refuzohen.
- (iv) Kur një Urdhërporosi ekzekutohet, Risku i ri i Urdhërporosive (R urdhërporositë) llogaritet duke zbritur Riskun që ishte shtuar nga Urdhërporosia e ekzekutuar, ndërsa Risku i ri i Tregtimit (R tregtimet) llogaritet duke shtuar Riskun nga tregtimi i ri.

Kombinimi i Urdhërporosive, të përmendura në paragrafët e mësipërm, është funksion teknik, ku dy ose më shumë Urdhërporosi, të deklaruara nga Anëtari i Bursës nëpërmjet Sistemit (ETSS), janë të kombinuara për të reduktuar Riskun total të Urdhërporosive. Për pranimin e kësaj deklarate, duhet të përmbushen kushtet e parashikuara në Shtojcën I.

### 2.2.1. Llogaritja e Riskut të Urdhërporosive

- (a) Risku i Urdhërporosive (R urdhërporositë) është Risku i ndërmarrë prej Anëtarit të Klerimit nga Urdhërporositë që mbeten aktive gjatë seancës së tregtimit, i cili llogaritet para hyrjes së çdo Urdhërporosie ose kombinimi të Urdhërporosive, për Llogari Klerimi të mbajtur nga Anëtari i Klerimit për Anëtar Burse të cilit i është caktuar Kufiri i Kreditit:

$$R_{\text{urdhërporositë}} = \sum_j [\max(V_{\text{urdhërporositë } j}, 0)] + \sum_k [\max(V_{\text{kombinimi i urdhërporosive } k}, 0)]$$

ku,

$j$  = urdhërporosia

$V_{\text{urdhërporositë } j}$  = vlera e Urdhërporosisë  $j$  që nuk është përfshirë në një kombinim të Urdhërporosive

$k$  = kombinimi i Urdhërporosive

$V_{\text{kombinimi i urdhërporosive } k}$  = vlera e kombinimit të urdhërporosive  $k$

- (b) Për llogaritjen e vlerës së Urdhërporosive Blerje ose Shitje, procedohet si në vijim:
- (i) Për ata që kanë një çmim specifik, llogaritet detyrimi ose pretendimi maksimal i mundshëm në para për Anëtarët e Bursës. Nëse tregtimi rezulton me një pretendim për Anëtarin e Bursës, shenja e vlerës së Urdhërporosisë është negative dhe për këtë arsye nuk konsiderohet në Riskun e Urdhërporosisë.
- (ii) Veçanërisht për llogaritjen e vlerës së Urdhërporosive për Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi, si çmim përdoret Çmimi i Referencës, i cili llogaritet sipas paragrafit 2.2.2 të këtij Vendimi Teknik.
- (c) Për llogaritjen e vlerës së kombinimit të Urdhërporosive, llogaritet detyrimi maksimal i mundshëm në para i Anëtarit të Bursës. Nëse transaksionet rezultojnë në një pretendim për Anëtarin e Bursës, shenja e vlerës të kombinimit të Urdhërporosive është negative dhe për këtë arsye ajo nuk konsiderohet në Riskun e Urdhërporosisë.
- (d) Në shtojcën I, ka një përshkrim të hollësishëm të llogaritjes së Riskut të Urdhërporosive për çdo Lloj Urdhërporosie dhe për kombinimin e Urdhërporosive.

### 2.2.2. Llogaritja e Çmimit të Referencës

- (a) Për llogaritjen e Riskut të Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi, përdoren Çmimet Referencë që llogariten në vetëm për llojin e Urdhërporosisë (blerje ose

shitje), Zonë e Ofertimi, Tregjet (Ankandit të tregut të Ditës në Avancë ose Ankandeve Lokale / Plotësuese Rajonale Brenda së Njëjtës Ditë), për Ditën e Livrimit (ditë pune ose jo) dhe Njësia Kohore e Tregut. Çmimet e Referencës llogariten bazuar në një model i cili merr në konsideratë historikun kohëve të fundit të Çmimeve Klerues në Segmentin e Ankandit të Ditës në Avancë dhe Ankandeve Plotësuese Rajonale ose Lokale Brenda së Njëjtës Ditë (LIDA dhe CRIDA). Çmimet e Referencës të aplikueshme shpallen në bazë ditore në Sistemin Elektronik të Tregtimit në Çast (ETSS) dhe në Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS).

- (b) Llogaritja e Çmimit të Referencës kryhet në ditë pune.
- (c) Çmimi i Referencës për Urdhërporositë blerje llogaritet për secilin segment të Tregjeve të ALPEX-it, Ditë Livrimi, Njësi Kohore Tregu dhe Zonë Ofertimi, si çmimi që është më i madh së 90% e vëzhgimeve gjatë 30 Ditëve të fundit të Livrimit të të njëjtit lloj që kanë të bëjnë me të njëjtin Treg, Njësi Kohore Tregu dhe Zonë Ofertimi, me zero (0) si çmim minimal. Nëse nuk ka çmime të disponueshme për ekzekutimin e llogaritjes së mësipërme për një treg, atëherë do të përdoret Çmimi më i madh përkatës Referues që rrjedh për tregjet e tjera.
- (d) Çmimi Referencë për Urdhërporositë shitje llogaritet për secilin segment të Tregjeve të ALPEX-it, Ditë Livrimi, Njësi Kohore Tregu dhe Zonë Ofertimi, si çmimi që është më i madh së 5% e vëzhgimeve gjatë 30 Ditëve të fundit të Livrimit të të njëjtit lloj që kanë të bëjnë me të njëjtin Treg, Njësi Kohore Tregu dhe Zonë Ofertimi, me zero (0) si çmim maksimal. Nëse nuk ka çmime të disponueshme për ekzekutimin e llogaritjes së mësipërme për një treg, atëherë do të përdoret Çmimi më i vogël përkatës Referues që rrjedh për tregjet e tjera.
- (e) Çmimet Reference të llogaritura më sipër mund të rillogariten në mënyrë të posaçme nga ALPEX, për shkak të kushteve të veçanta, me qëllim të mbrojtjes së tregut. ALPEX është i detyruar të informojë ERE menjëherë për aplikimin e masave të jashtëzakonshme si dhe arsyet që sollën aplikimin e këtyre masave.

### 2.2.3. Llogaritja e Riskut të Tregtimit

- (a) Risku i Tregtimit (R tregtimi) është Risku i ndërmarrë nga Anëtari i Klerimit për tregtimet të cilat janë ekzekutuar gjatë seancës së tregtimit. Llogaritet pas ekzekutimit të çdo tregtimi për Llogari Klerimi dhe për Anëtar Burse, të cilit i është caktuar Kufiri i Kreditit si më poshtë:

$$R_{\text{tregtimi}} = \sum_i v_i$$

ku,

$i$  = tregtimi

$V_i$  = vlera e tregtimit  $i$

- (b) Vlera e tregtimit llogaritet si detyrim ose pretendim në para i Anëtarit të Bursës në lidhje me tregtimin. Nëse tregtimi rezulton në një pretendim për Anëtarin e Bursës, shenja e vlerës së tregtimit është negative.

### NENI 3

## **3. PËRKUFIZIMI I GARANCISË SË PRANUESHME PËR MBULIMIN E LLOGARITJES SË MARGJINËS TË SEKSIONIT G.3.2, TË RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE - PROCEDURËS SË KLERIMIT DHE SHLYERJES**

### **3.1. Pranimi i Garancisë**

- (a) Si garanci të pranueshme të seksionit G.3.2 të Kapitullit G të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes janë përcaktuar:
- (i) Garanci në Para,
  - (ii) Letër Garanci Bankare, të cilat përputhen me kërkesat e seksionit G.3.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, sipas një shembulli standard, të parashikuar në Shtojcën II.
- (b) Letrat e Garancisë Bankare konsiderohen deri në ditën e pestë të punës para skadimit të tyre.
- (c) Për pranimin e Garancisë nga ALPEX, sipas seksionit G.3.2 të Rregullave Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, Anëtari i Klerimit duhet të deklarojë mënyrën e ndarjes së garancisë për Llogari Klerimi, si më poshtë:
- (i) Për pranimin e garancisë në formën e parave, deklarata Anëtarit të Klerimit i kërkohet të deklarojë mënyrën e ndarjes së tij, me shkrim, sipas formës standarde "Garanci në formën e parave".
  - (ii) Për pranimin e garancisë në formën e Letër Garanci Bankare nga ALPEX, Anëtarit të Klerimit i kërkohet të deklarojë mënyrën e ndarjes së tij, me shkrim, sipas formës standarde "Garanci në formën e Letër Garanci Bankare".
- (d) Për të kthyer garancinë e marrë nga ALPEX sipas G.2.2 të kapitullit G të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes zbatohen këto:
- (i) Për të kthyer garancinë në para, deklarata e kthimit transmetohet në ALPEX në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit EMCS.

- (ii) Për të kthyer garancinë në formën e Letrës së Garancisë Bankare përpara skadimit të saj, kërkohet një deklaratë me shkrim nga Anëtari i Klerimit, e transmetuar nëpërmjet email-it tek ALPEX, sipas formës standarde "Garanci për tu kthyer në formën e një Letre Garancie Bankare përpara skadimit të saj".
- (e) Kthimi i garancisë kryhet:
- (i) nëse i referohet garancisë të dhënë në formën e parave, kthimi i garancisë realizohet në ditën tjetër të punës të kërkesës së kthimit, përveç kur ALPEX e gjykon të nevojshme kthimin më herët, për mbulimin e detyrimeve lidhur me EMCS,
- (ii) nëse i referohet garancisë të dhënë në formën e Letër Garancisë Bankare, kthimi i garancisë realizohet në ditën e ardhshme të punës së kërkesës së kthimit ose në ditën e ardhshme të punës së skadimit së bashku me paraqitjen e formularit standard të autorizimit "Autorizimi për të marrë një Letër Garanci Bankare nga ALPEX".

### 3.2. Përqendrimi i Kufijve të Garancisë

- (a) Në zbatim të seksionit G.3.2 të Kapitullit G të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, në vijim janë përcaktuar:
- (i) Përqindja e Margjinës së kërkuar për Llogari Klerimi e cila duhet të mbulohet me para në bazë ditore minimumi 70% dhe;
- (ii) Kufiri maksimal i garancisë në formën e Letrave të Garancisë Bankare nga një Lëshues i Letër Garancisë Bankare (LoG) është vendosur si një total i të gjitha Llogarive të Klerimit, si më poshtë:

Nr.	Banka e cila ka	Ekspozimi maksimal i Letër Garancive për një bankë
1	Më e > se 10% e totalit të aseteve të sistemit bankar	2.000.000 €
2	Më e > se 5% më e < se 10% e totalit të aseteve të sistemit bankar	1.200.000 €
3	Më e > se 3% më e < se 5% e totalit të aseteve të sistemit bankar	700.000 €
4	Më e > se 1% më e < se 3% e totalit të aseteve të sistemit bankar	300.000 €
5	Më e < se 1% e totalit të aseteve të sistemit bankar	150.000 €



## NENI 4

- 4. RREGULLAT PËR LLOGARITJEN E FONDIT TË MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE, SIPAS SEKSIONEVE E.1.2, E.1.3, E.2.1 AND E.2.2 TË RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE - PROCEDURËS SË KLERIMIT DHE SHLYERJES.**
- 4.1. Kontributi fillestar dhe minimal sipas seksionit E.1.3 të Kapitullit E të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes**
- (a) Shuma e kontributit fillestar të Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit është në 150.000 Euro (një qind e pesëdhjetë mijë)
  - (b) Shuma e kontributit fillestar të Anëtarëve të Personal të Klerimit është në 30.000 Euro (tridhjetë mijë)
- 4.2. Periudha kohore e llogaritjes së Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve sipas seksionit E.2.1 dhe seksionit E.2.2 të Kapitullit E të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes**
- (a) Madhësia e Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve llogaritet në bazë mujore dhe për qëllimet këtij termi "periudha e llogaritjes" i referohet periudhave nga dita e parë deri në ditën e fundit të çdo muaji në një vit kalendarik.
- 4.3. Norma e kontributit sipas seksionit E.2.1 të Kapitullit E të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes**
- (a) Norma e Kontributit (a) sipas seksionit E.2.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes është vendosur të jetë e barabartë me 100%.
- 4.4. Rregullimi i Pjesës Proporcionale të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve si rezultat i transformimit të korporatave ose ngjarjeve të tjera në lidhje me Anëtarët e Klerimit sipas seksionit E.1.2 të Kapitullit E të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes**
- (a) Në rast bashkimi të Anëtarëve të Klerimit ose veprimeve të tjera të rëndësishme të korporatave, Pjesa Proporcionale në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve të Anëtarit të Klerimit i cili mban kapacitetin do të jetë e barabartë me shumën e Pjesës Proporcionale të të gjithë anëtarëve që bashkohen deri në rregullimin e ardhshëm ose të rregullimit të jashtëzakonshëm të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve. Në rregullimin e ardhshëm ose të jashtëzakonshëm të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve, për përcaktimin e Pjesës Proporcionale të Anëtarit të Klerimit i cili mban kapacitetin, fillimisht do të llogaritet Pjesa Proporcionale e Anëtarit të Klerimit i cili mban kapacitetin për periudhën kohore të llogaritjes përpara bashkimit, e cila do të llogaritet duke marrë parasysh Margjinën e Llogarive të Klerimit të të gjithë Anëtarëve të Klerimit që bashkohen

dhe pastaj do të llogaritet Pjesa Proporcionale e Anëtarit të Klerimit i cili mban kapacitetin për periudhën kohore të llogaritjes pas bashkimit, e cila do të llogaritet duke marrë parasysh vetëm Margjinën e Llogarive të Klerimit të Anëtarit të Klerimit që mban kapacitetin. Për përcaktimin përfundimtar të Pjesës Proporcionale të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve të Anëtarit të Klerimit që mban kapacitetin, Pjesa Proporcionale që rezulton nga llogaritjet e mësipërme do të llogariten në proporcional me numrin e ditëve të periudhës kohore të mësipërme.

- (b) Në rast transferimi të Llogarisë së Klerimit tek një Anëtar tjetër i Klerimit, në rregullimin e ardhshëm ose në rregullimin e jashtëzakonshëm të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve, për përcaktimin e Pjesës Proporcionale të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve të Anëtarit të Klerimit tek i cili transferohet Llogaria e Klerimit, Pjesa e tij Proporcionale do të llogaritet, për kohën e periudhës së llogaritjes përpara transferimit, duke marrë në konsideratë Margjinën e Llogarisë së Klerimit të transferuar, dhe Pjesa e tij Proporcionale gjithashtu do të llogaritet për kohën e periudhës së llogaritjes pas transferimit. Për përcaktimin përfundimtar të Pjesës Proporcionale të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve të Anëtarit të Klerimit të cilit i transferohet Llogaria e Klerimit, Pjesa Proporcionale që rezulton nga llogaritjet e mësipërme do të llogariten në proporcional me numrin e ditëve të periudhës kohore të mësipërme.
- (c) Në rast të fshirjes së një Llogarie Klerimi, duke përfshirë edhe transferimin e saj tek një Anëtar tjetër Klerimi, për përcaktimin e Pjesës Proporcionale të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve të Anëtarit të Klerimit të cilit i është fshirë Llogaria e Klerimit, Pjesa Proporcionale do të llogaritet gjatë rregullimit të ardhshëm ose rregullimit të jashtëzakonshëm të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve, pa marrë parasysh Margjinën e Llogarisë së fshirë të Klerimit.

## NENI 5

### **5. PJESA PROPORCIONALE FILLESTARE E FONDIT TË MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE DHE ÇMIMET E REFERENCËS**

#### **5.1. Pjesa Proporcionale fillestare e Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve**

- (a) Me fillimin e funksionimit të Tregut të Ditës në Avancë ose Tregut Brenda së Njëjtës Ditë, llogaritja fillestare e Pjesës Proporcionale të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve për çdo Anëtar Klerimi, dhe me krijimin e Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve, do të zbatohet seksioni E.2.1 i Kapitullit E të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, ku Margjina e një Llogarie Klerimi për çdo ditë Klerimi do të konsiderohet si vlera maksimale midis vlerës së netimit të transaksioneve (blerje

minus shitje) dhe zero, që janë ekzekutuar nga Anëtari i Bursës, Llogarisë respektive të Klerimit, sipas Orarit (skedulit) të Ditës në Avancë (DAS) për çdo ditë të muajit të mëparshëm nga zbatimi i Tregut të Ditës në Avancë dhe/ose Tregut Brenda së Njëjtës Ditë. Llogaritja do të kryhet pesë (5) ditë pune përpara fillimit të funksionimit të Tregjeve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë dhe Pjesa Proporcionale e Anëtarit të Klerimit do të llogaritet duke marrë parasysh Llogaritë e Klerimit të Anëtarit të Klerimit siç ata kanë deklaruar atë ditë.

## **5.2. Çmimet fillestare të Referencës**

- (a) Llogaritja e çmimeve referencë do të kryhet sipas paragrafit 2.2.2 të këtij Vendimi Teknik, me dallimin e vetëm së për ato ditë dhe orë që nuk ka çmime në dispozicion të Tregut të Ditës në Avancë dhe Tregut Brenda së Njëjtës Ditë, do të përdoren çmimet përkatëse sipas Orarit (skedulit) të Ditës në Avancë (DAS).

## **NENI 6**

### **6. HYRJA NË FUQI**

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi që nga data 07/09/2023.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen zyrtare të internetit [www.alpex.al](http://www.alpex.al).

## **SHTOJCA I.**

### **LLOGARITJA E RISKUT TË URDHËRPOROSIVE**

1. Për llogaritjen e riskut të një urdhërporosie blerjeje ose shitjeje, për çdo lloj Urdhërporosie, aplikohet si në vijim:
  - Për një **Urdhërporosi të Thjeshtë** të përbërë nga segmente me hapa, për çdo Njësi Kohore Tregu të Ditës së Livrimit D, risku i urdhërporosisë është i barabartë me vlerën maksimale potenciale  $V_{max}$  midis vlerave maksimale potenciale  $V_i$  të llogaritura për çdo segment individual (i), i cili llogaritet si më poshtë:
    - 1) Për segmentet me hapa vlera  $V_i$  llogaritet si më poshtë:
      - Për urdhërporosi blerje  
Është i barabartë me prodhimin e çmimit dhe sasisë totale.
      - Për Urdhërporosi Shitje  
Në rastin e një Urdhërporosi Shitjeje, vetëm hapat me çmim negativ mund të prodhojnë risk. Për këto hapa, vlera  $V_i$  është e barabartë me shenjën e kundërt të prodhimin të çmimit dhe sasisë totale.
  - Për një **Urdhërporosi Blerjeje në Bllok**, nëse çmimi i Urdhërporosisë është pozitiv, risku i urdhërporosisë është i barabartë me prodhimin e çmimit të Urdhërporosisë dhe shumës së sasive të segmenteve individuale të Urdhërporosive në Bllok, dhe nëse çmimi i urdhërporosisë është negativ, atëherë risku i urdhërporosisë është i barabartë me zero. Për një **Urdhërporosi Shitjeje në Bllok**, nëse çmimi i urdhërporosisë është pozitiv, risku i urdhërporosisë është i barabartë me zero, dhe nëse çmimi i urdhërporosisë është negativ atëherë risku i urdhërporosisë është i barabartë me shenjën e kundërt të prodhimin të çmimit të urdhërporosisë dhe shumën e sasive të segmenteve individuale të urdhërporosisë në bllok.
  - Për një **Urdhërporosi Blerjeje të lidhur në Bllok**, në qoftë së çmimet e të gjitha urdhërporosive të lidhura në bllok janë pozitive, risku i urdhërporosive është i barabartë me shumën, midis të gjitha blloqeve të lidhura (blloqet e lidhura udhëheqës & vartës), të prodhimin të çdo çmimi në bllok dhe shumës së sasive të segmenteve individuale të bllokut përkatës, dhe në qoftë së çmimi i një urdhërporosi blerjeje të lidhur në bllok është negativ, atëherë risku i bllokut korrespondues është zero dhe nuk përfshihet në këtë shumë. Për një **Urdhërporosi Shitjeje të lidhur në Bllok**, në qoftë së çmimet e të gjitha urdhërporosive të lidhura në bllok janë pozitive, risku i urdhërporosive është zero, dhe nëse çmimet e disa urdhërporosi shitjeje të lidhura në bllok janë negative, atëherë risku i urdhërporosisë është i barabartë me këtë shumë, midis të gjitha blloqeve me çmim negativ, me shenjën negative të prodhimin të çmimit të urdhërporosive të çdo blloku dhe shumës së sasive të segmenteve individuale të bllokut përkatës.

- Për **grupin ekskluziv të Urdhërporosive në Bllok**, risku i urdhërporosive është i barabartë me maksimumin midis risqeve individuale (maksimale) të të gjitha blloqeve të grupit, të llogaritura si prodhim i çmimit të bllokut korrespondues dhe shumës së sasive të segmenteve individuale të bllokut të blerjes / shenja e kundërt prodhimit të çmimit të bllokut korrespondues dhe shumës së sasive të segmenteve individuale të bllokut të shitjes.
2. Për llogaritjen e riskut të Urdhërporosive të Kombinuara kërkohet që 2 Urdhërporositë kanë të bëjnë me të njëjtën Llogari Klerimit (nën-llogari) dhe të njëjtën Njësi Kohore Tregu. Dallohen 4 rastet e mëposhtme për zbatimin e llogaritjes së riskut të urdhërporosive të kombinuara:
- A. Në rastin e një urdhërporosi blerjeje të thjeshtë me një hap të çmimit dhe një urdhërporosi shitjeje të thjeshtë me një hap të çmimit ku çmimi i urdhërporosisë së blerjes ( $P_b$ ) > çmimin e urdhërporosisë së shitjes ( $P_s$ ) atëherë llogaritja e riskut (kufiri i kreditit të kërkuar për urdhërporositë) për kombinimin e urdhërporosive do të kryhet me formulën e mëposhtme:
- $$K = \max[0, P_s * Q_b, P_b * (Q_b - Q_s), -P_s * (Q_s - Q_b), -P_b * Q_s]$$
- ku:
- K : risku i urdhërporosive të kombinuara
- $P_s$ : çmimin e urdhërporosisë shitje,
- $P_b$ : çmimin e urdhërporosisë blerje,
- $Q_s$ : sasia e urdhërporosisë shitje, dhe
- $Q_b$ : sasia e urdhërporosisë blerje.
- B. Në rastin e dy Urdhërporosive Marrëse të Çmimit me Përparësi (PPT), llogaritja e riskut (kufiri i kreditit të kërkuar për urdhërporositë) për kombinimin e urdhërporosive do të kryhet me formulën e mëposhtme:
- $$K = \max[0, R_b * (Q_b - Q_s), R_s * (Q_b - Q_s)]$$
- Ku:
- K : risku i urdhërporosive të kombinuara
- $R_s$ : çmimi i referencës i përdorur për Urdhërporosi Shitje Marrëse e Çmimit me Përparësi,
- $R_b$ : çmimi i referencës i përdorur për Urdhërporosi Blerje Marrëse e Çmimit me Përparësi,
- $Q_s$ : sasia e urdhërporosisë shitje, dhe
- $Q_b$ : sasia e urdhërporosisë blerje.

C. Në rastin e kombinimit të një urdhërporosi blerje Marrëse e Çmimit me Përparësi dhe një urdhërporosie të thjeshtë shitjeje me një hap të çmimit, llogaritja e riskut (kufiri i kreditit të kërkuar për urdhërporositë) për kombinimin e urdhërporosive do të kryhet si vijon:

a) Nëse  $Q_b \geq Q_s$

$$K = \max[\min(Q_b \cdot P_s, Q_b \cdot R_b), R_b \cdot (Q_b - Q_s), 0]$$

b) Nëse  $Q_b < Q_s$

$$K = \max[\min(Q_b \cdot P_s, Q_b \cdot R_b), P_s \cdot (Q_b - Q_s), 0]$$

K : risku i urdhërporosive të kombinuara

$P_s$ : çmimin e urdhërporosisë shitje,

$R_b$ : çmimi i referencës i përdorur për urdhërporosi blerje Marrëse e Çmimit me Përparësi,

$Q_s$ : sasia e urdhërporosisë shitje, dhe

$Q_b$ : sasia e urdhërporosisë blerje.

D. Në rastin e kombinimit të një urdhërporosie të thjeshtë blerjeje me një hap të çmimit dhe një urdhërporosi shitje Marrëse e Çmimit me Përparësi, llogaritja e riskut (kufiri i kreditit të kërkuar për urdhërporositë) për kombinimin e urdhërporosive do të kryhet si vijon:

a) Nëse  $Q_b \geq Q_s$

$$K = \max[\min(-Q_s \cdot P_b, -Q_s \cdot R_s), P_b(Q_b - Q_s), 0]$$

b) Nëse  $Q_b < Q_s$

$$K = \max[\min(-Q_s \cdot P_b, -Q_s \cdot R_s), R_s \cdot (Q_b - Q_s), 0]$$

Ku:

K : risku i urdhërporosive të kombinuara

$P_b$ : çmimin e urdhërporosisë blerje,

$R_s$ : çmimi i referencës i përdorur për urdhërporosi shitje Marrëse e Çmimit me Përparësi,

$Q_s$ : sasia e Urdhërporosisë shitje, dhe

$Q_b$ : sasia e Urdhërporosisë blerje,

Për çdo rast tjetër kombinimi i urdhërporosive për llogaritjen e riskut nuk lejohet.

**SHTOJCA II.**

**LETËR GARANCI BANKARE**

**Ref. xxxx**

**Nr. \_\_\_\_\_ Prot.**

**Tiranë / Prishtinë më dd/mm/yyyy**

**Garantori:** ....(detajet e Bankës Garantore)...

**Përfituesi:** Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike Sh.a / Dega ne Kosovë

Adresa: Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic,

Shkalla 3, Kati 1, Zyra 1, Tiranë, Shqipëri

NIPT: M02223006B /

Adresa në Kosovë: Rruga Ali Pashë Tepelena,

VIP TOWER, Kati II, Nr.1, Prishtinë, Kosovë

NUI: 811568495

(me tej referuar si ‘ALPEX’)

**Aplikanti:** (plotëso emrin, adresën dhe Nipt-in/NUI-in e aplikantit)

(më tej referuar si ‘Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit’)

Ne jemi informuar nga \_\_\_\_\_ (plotëso emrin e aplikantit) se do të marr pjesë në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për transaksionet e kryera në Tregjet e ALPEX-it për shitjen dhe blerjen me shumicë të Energjisë Elektrike, në rolin e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit.

Duke marrë në konsideratë sa më lart, në, ..... (... emri, adresa e Bankës Garantore.. )..., garantojmë në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar, të paguajmë pa ndonjë kundërshtim dhe pa kërkuar konfirmimin e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, me të marrë kërkesën tuaj të parë me shkrim të firmosur rregullisht nga përfaqësuesi ligjor i ALPEX, çdo shumë apo shuma që nuk tejkalon në total shumën \_\_\_\_\_ (me fjalë: \_\_\_\_\_) ('Shuma Maksimale e Garancisë') brenda 7 (shtatë) ditë pune bankare në një llogari të përcaktuar nga ju.

Kërkesa juaj për pagesë duhet të shoqërohet me deklaratën tuaj origjinale të shkruar dhe të firmosur rregullisht nga përfaqësuesi ligjor i ALPEX, në të cilën të deklarohet se ..... ( *plotëso emrin e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit*) nuk ka përmbushur detyrimet e pagesës që rrjedhin nga pjesëmarrja si Anëtar i Përgjithshëm Klerimi.

Dorëzimi i një kërkesë të tillë pagese do të jetë kushti i vetëm për çdo pagesë që do të kryhet në bazë të një garancie të tillë, pa asnjë verifikim tjetër që do të bëhet nga Banka dhe asnjë dëshmi tjetër që duhet paraqitur nga ju.

Kërkesa juaj për pagese me shkrim së bashku me deklaratën shoqëruese, duhet të prezantohen zyrtarisht në adresën e bankës sonë si më poshtë:

.....

.....

Shuma maksimale e kësaj garancie do të reduktohet në mënyrë automatike pas çdo pagese të kryer nën këtë garanci, si rezultat i një kërkesë për pagesë, pa asnjë lloj modifikimi të mëtejshëm nga ana jone.

Të gjitha dokumentet e specifikuar e të paraqitura nën këtë garanci duhet të jenë në gjuhën Shqipe ose Angleze.

Kjo garanci është e vlefshme deri në datë dd/mm/yyyy ('data e skadencës') dhe skadon plotësisht dhe automatikisht nëse kërkesa juaj për pagesë nuk është bërë në këtë datë ose para kësaj date, pavarësisht nëse kjo datë është ditë pune ose jo. Pas kësaj date, kjo garanci bëhet automatikisht e pavlefshme, pavarësisht nëse ky dokument origjinal do të kthehet tek ne apo jo.

Kjo garanci do të jetë subjekt i rregullave Standarde për Garancitë Bankare - Uniform Rules for Demand Guarantees (URDG) botimi nr. 758 i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC). Për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga këto rregulla kjo Garanci është subjekt i Ligjit Shqiptar / Ligjeve të Kosovës.

Për llogari të

....

(firmat e autorizuara)



### **SHTOJCA III.**

*(hapat që duhen ndjekur në lidhje me komunikimin me ALPEX, të zbatueshme në rastet kur Anëtari i Klerimit vendos të modifikojë Garancinë në Para)*

#### **Rregullat e Komunikimit**

Për përmbushjen në kohë dhe në mënyrën e duhur të detyrimeve të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit kundrejt ALPEX në përputhje me kërkesat specifike të seksionit G.5.2.6 (d) të "Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes", Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit duhet të njoftojë ALPEX për rritjen e shumës së mbajtur në Llogarinë bankare të Garancisë në Para me Nr. \_\_\_\_\_ në favor të ALPEX, e cila do të përdoret për rritjen e kufirit të kreditit të Llogarisë e përkatëse të Klerimit. Kjo Garanci në Para korrespondon me të paktën 70% të shumës së kufirit të kreditit të një ose më shumë Llogarive të Klerimit të Anëtarëve të Bursës.

Ky njoftim do të dërgohet ALPEX jo më vonë se ora **11:00 CET** e D-1 në lidhje me ditën e Ditën e Livrimit D.

Komunikimi nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit drejt ALPEX do të kryhet duke përmbushur njëkohësisht tre mënyrat e komunikimit si më poshtë vijon:

1. **Nëpërmjet email-it:** Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit do të dërgojë ekstraktin e llogarisë të skanuar dhe ky dokument duhet të përmbajë vulën e kompanisë dhe firmën e Agjentit Klerues të Certifikuar i Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit (skanimi duhet të jetë me ngjyra). Adresat e email-it të përdorura do të jenë të paracaktuara; për ALPEX – [clearing@alpe.al](mailto:clearing@alpe.al), dhe për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit – [bank@bank.al](mailto:bank@bank.al). Dërguesi i email-it në emër të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit do të jetë gjithmonë një nga Agjentët Klerues të Certifikuar të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit. Email-i do të ketë si adresë në kopje një nga menaxherët e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit të përcaktuar në formën standarte CL-1-F2 dhe një nga Menaxherët e ALPEX.
2. **Nëpërmjet telefonatës së regjistruar:** Në të njëjtën kohë që dërgohet email-i në hapin e parë, Agjenti Klerues i Certifikuar i Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit do të telefonojë ALPEX me telefon fiks në numrin e mëposhtëm: +355 42 xxxxxx, nëpërmjet numrit të telefonit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit: +355 42 xxxxxx. Telefonuesi duhet të identifikohet me emrin, mbiemrin dhe kodin e certifikimit të Agjentit Klerues i Certifikuar. Më pas telefonuesi duhet të deklarojë përmbajtjen e email-it që është dërguar në hapin e parë duke përfshirë shumën e shtuar me transfertë në Llogarinë bankare të Garancisë në Para me nr. \_\_\_\_\_.

Kjo telefonatë do të regjistrohet dhe do të arkivohet si provë e modifikimit në Llogarinë bankare të Garancisë në Para. Ky regjistrim do të jetë subjekt i Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" / Ligjit NR. 06/L-082 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3. **Nëpërmjet postës:** pasi të jenë përmbushur dy hapat e parë nga Agjenti Klerues i Certifikuar i Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, dokumenti origjinal në kopje fizike, i cili është skanuar dhe dërguar me email, do të dërgohet me postë të shpejtë, në adresën postare të ALPEX jo më vonë se **11:45 CET e D-1**.



Pas përmbushjes së njëkohshme të të tre mënyrave të mësipërme, ALPEX do të kontrollojë dokumentin përkatës dhe do të vijojë me rritjen e kufirit të kreditit për Llogarinë përkatëse të Klerimit.